



# **culture 21**

Agenda 21 for culture  
Agenda 21 de la culture  
Agenda 21 de la cultura

**Qytetet dhe qeveritë lokale të bashkuara  
- Komiteti për kulturë**

## **Agjenda 21 për kulturë**



**Ajuntament de Barcelona**  
**Barcelona Cultura**



**United Cities and Local Governments**  
**Cités et Gouvernements Locaux Unis**  
**Ciudades y Gobiernos Locales Unidos**

---

QYTETET DHE QEVERITË LOKALE TË BASHKUARA  
– KOMITETI PËR KULTURË

# Agjenda 21 për kulturë



Ajuntament de Barcelona  
Institut de Cultura



United Cities and Local Governments  
Cités et Gouvernements Locaux Unis  
Ciudades y Gobiernos Locales Unidos



**culture 21**

Agenda 21 for culture  
Agenda 21 de la culture  
Agenda 21 de la cultura

---


Agjenda 21 për kulturë është dokumenti i parë me mision botëror që avokon vendosjen e një baze të punës për qytetet dhe qeveritë lokale për zhvillimin kulturor.

Agjenda 21 për kulturë është marrëveshje e arritur nga qytetet dhe qeveritë lokale nga e tërë bota, e vendosur për të drejtat e njeriut, diversitet kulturor, qëndrueshmëri, demokraci pjesëmarrëse dhe krijim të kushteve për paqe. Është miratuar nga Forumi IV-të i Autoriteteve Lokale për Përfshirje Sociale të Porto Alegre-s, i mbajtur në Barcelonë më 8 maj 2004 si pjesë e Forumit të parë Universal të Kulturave.

Organizata botërore Qytetet dhe Qeveritë Lokale të Bashkuara (QQLB) ka miratuar Agjendën 21 për kulturë si dokument referimi për programet e saj për kulturë duke pretenduar rolin e koordinatorit të procesit pas miratimit të saj. Komiteti i QQLB-së për kulturë është pikëtakim për qytetet, qeveritë lokale dhe rrjetet që e vendosin kulturën në zemrën e proceseve të tyre zhvilluese.

Një numër në rritje i qyteteve dhe qeverive lokale anembanë botës e kanë mbështetur Agjendën 21 për kulturë në këshillat e tyre lokale. Procesi ka ngritur interesin e organizatave ndërkombëtare, qeverive nacionale dhe shoqërisë civile.

Përkthimi i Agjendës 21 për kulturën në gjuhën shqipe është realizuar nga Komuna e Prishtinës dhe OJQ 're: Public'



---

## Si ta miratoni Agjendën 21 për kulturë në komunën tuaj

Rreth 400 qytete, qeveri lokale dhe organizata nga e tërë bota janë të lidhura me Agjendën 21 për kulturë. Lista complete përtërihet vazhdimisht në uebfaqe.

Miratimi formal i Agjendës 21 për kulturë nga një qeveri lokale është i një rëndësie të madhe: e shprehë marrëveshjen me qytetarët për t'u siguruar që kultura të marrë rol kyç në politikën urbane si dhe është shenjë e solidaritetit dhe bashkëpunimit me qytetet dhe qeveritë lokale të botës.

Formulari standard për miratimin e Agjendës 21 për kulturë gjendet në uebfaqe. Për t'u siguruar që të dhënat për miratimet e reja janë të freskëta, qytetet dhe qeveritë lokale lutën që ta dërgojnë një kopje të rezolutës së miratuar në mbledhjen e këshillit plenar në adresën:

- Sekretariati Botëror i Qyteteve dhe Qeverive Lokale të Bashkuara:  
[info@cities-localgovernments.org](mailto:info@cities-localgovernments.org)
- Sekretariati i Komitetit për kulturë:  
[agenda21cultura@bcn.cat](mailto:agenda21cultura@bcn.cat)

Për më shumë, preferohet të dërgohet një kopje e rezolutës në:

- Sekretariatit e Përgjithshëm të Asociacionit të Qyteteve dhe Komunave në vendin tuaj
- Ministrinë e Kulturës së vendit tuaj

## Si të zbatohet Agjenda 21 për kulturë në komunën tuaj

Agjenda 21 për kulturë ofron mundësi për çdo qytet të krijojë vizion afatgjatë për kulturën si shtyllë themelore në zhvillimin e qytetit. Dokumenti “Këshilla mbi zbatimin lokal të Agjendës 21 për kulturë” shtron koncepte dhe shqyrtime të përgjithshme dhe sugjeron katër mjete specifike, që janë:

- Strategjia kulturore lokale
- Karta e të drejtave dhe përgjegjësive kulturore
- Këshilli kulturor
- Vlerësimi i ndikimit të kulturës

Dokumentin “Këshilla mbi zbatimin lokal të Agjendës 21 për kulturë” në tërësi, mund ta shkarkoni nga uebfaqja.

## Si t'i bashkëngjiteni Komitetit për Kulturë të QQLB-së

Regjistrimi në Komitetin për Kulturë të QQLB-së mund të bëhet përmes formularit që mund ta merrni nga

[info@cities-localgovernments.org](mailto:info@cities-localgovernments.org)

---

# Përmbajtja e Agjendës 21 për kulturë

Agjenda 21 për kulturë i ka 67 artikuj, të ndarë në tre seksione të mëdha.

Seksioni i “parimeve” (16 artikuj) përshkruan marrëdhënien në mes të kulturës dhe të drejtave të njeriut, diversitetit, qëndrueshmërisë, pjesëmarrjes demokratike dhe paqes. “Ndërmarrjet” (29 artikuj) përqendrohen në shtrirjen e përgjegjësive të qeverisë lokale dhe japin përshkrime të detajuara të kërkesës për përqendrim të politikave kulturore. Seksioni i “rekomandimeve” (22 artikuj) avokon për ripërtëritjen e rëndësisë së kulturës dhe kërkon që kjo rëndësi të njihet në programet, buxhetet dhe kartat organizative të niveleve të ndryshme të qeverisë (lokale, nacionale/ shtetërore) dhe të organizatave ndërkombëtare.

Përmbajtja e Agjendës 21 për kulturë gjithashtu mund të përmbliidhet në tematikë.

## KULTURA DHE TË DREJTAT E NJERIUT

- Kultura dhe zhvillimi njerëzor. Diversiteti kulturor si “mjet për të arritur ekzistencë më të kënaqshme intelektuale, emocionale, morale dhe shpirtërore.”
- Të drejtat kulturore janë pjesë integrale e të drejtave të njeriut. “Askush nuk mund të thirret në diversitet kulturor që i cenon të drejtat e njeriut të garantuara me ligj ndërkombëtar, apo që i kufizon ato..”
- Mekanizmat, instrumentet dhe resurset që garantojnë lirinë e fjalës
- Thirrje për artistë që të zotohen për qytetin e tyre, duke përmirësuar bashkëjetesën dhe kualitetin e jetës, duke rritur kapacitetin kreativ dhe kritik të të gjithë qytetarëve

## KULTURA DHE QEVERISJA

- Roli i ri qendror i kulturës në shoqëri. Legjitimiteti i politikave kulturore
- Kualiteti i zhvillimeve lokale varet nga gërshetimi i politikave kulturore dhe politikave tjera publike
- Qeverisja lokale është përgjegjësi e përbashkët e qytetarëve, shoqërisë civile dhe qeverive
- Përmirësimi i mekanizmave vlerësues në kulturë. Sistemi i indikatorëve kulturorë
- Rëndësia e rrjeteve dhe bashkëpunimit ndërkombëtar
- Pjesëmarrja e qeverive lokale në politikën dhe programet kulturore nacionale

---

## KULTURA, QËNDRUESHMËRIA DHE TERRITORI

- Diversiteti kulturor domosdoshmëri për njerëzimin ashtu si është biodiversiteti për natyrën
- Laramania e shprehjes kulturor sjellin pasuri. Rëndësia e një ekosistemi të gjerë kulturor, me diversitetin e origjinës, akterëve dhe përmbajtjes
- Dialogu, bashkëjetesa dhe ndërkulturaliteti si parime bazë për dinamika të marrëdhënieve të qytetarëve
- Hapësirat publike si hapësira kulturore

## KULTURA DHE PËRFSHIRJA SOCIALE

- Qasja në kulturë në të gjitha etapat e jetës
- Të shprehurit si dimension themelor i dinjitetit njerëzor dhe përfshirjes sociale pa paragjykime në gjini, origjinë, varfëri apo ndonjë lloj tjetër diskriminimi.
- Ndërtimi i publikut dhe nxitja për pjesëmarrje kulturore si element vital i qytetarisë

## KULTURA DHE EKONOMIA

- Vlerësimi i dimensionit ekonomik të kulturës. Rëndësia e kulturës si faktor në krijimin e pasurisë dhe zhvillimit ekonomik
- Financimi i kulturës nga burime të ndryshme, si subvencionimet, fondet 'venture capital', mikro-kreditë ose stimulimi tatimor
- Roli strategjik i industrive kulturore dhe mediave lokale për kontributin e tyre në identitetin lokal, vazhdimësinë kreative dhe krijimin e vende të punës
- Marrëdhënia në mes të objekteve kulturore dhe entiteteve tjera që punojnë me njohuri ekonomike
- Respektim dhe garantim i të drejtave të autorëve dhe artistëve dhe sigurimi i shpërblimit të drejtë për ta

Uebfaqja <http://www.agenda21culture.net> i ka të gjitha resurset, duke përfshirë edhe përkthimet e dokumenteve në shumë gjuhë, artikuj, publikime, lajme dhe ngjarje.

---

# Agjenda 21 për kulturë

Ndërmarrjet e qyteteve dhe qeverive lokale për zhvillim kulturor

Ne, qytetet dhe qeveritë lokale të botës, zotohemi për të drejtat e njeriut, diversitet kulturor, qëndrueshmëri, demokraci pjesëmarrëse dhe krijim të kushteve për paqe, të mbledhur më 7 dhe 8 maj 2004, në Forumin IV të Porto Alegre-s të Autoriteteve Lokale për Përfshirje Sociale, në kuadër të Forumit Universal të Kulturave – Barcelona 2004, jemi pajtuar për këtë Agjendë 21 për Kulturë si dokument udhëzues për politikën tona kulturore publike dhe si kontribut për zhvillimin kulturor të njerëzimit.

## I. Parimet

1. Diversiteti kulturor është trashëgimia kryesore e njerëzimit. Është produkt i mija viteve të historisë, fryt i kontributit kolektiv të të gjithë njerëzve përmes gjuhëve, imagjinatës, teknologjive, praktikave dhe krijimeve të tyre. Kultura merr formë të ndryshme, duke iu përgjigjur modeleve dinamike të marrëdhënies në mes të shoqërive dhe territoreve. Diversiteti kulturor është “mjet për të arritur ekzistencë më të kënaqshme intelektuale, emocionale, morale dhe shpirtërore” (UNESCO Deklarata Universale mbi Diversitetin Kulturor, artikulli 3) dhe është njëri nga elementet esenciale në transformimin e realitetit urban dhe social.
2. Analogji të qarta politike ekzistojnë në mes të çështjeve kulturore dhe ekologjike, pasi që edhe kultura edhe ambienti janë pronë e përbashkët e mbarë njerëzimit. Modelet aktuale të zhvillimit ekonomik, të cilat jashtë mase dëmtojnë resurset natyrore dhe të mirat e përbashkëta të njerëzimit, janë shkak për rritjen e brengës për mjedisin. Rio de Zhaneiro 1992, Aalborg 1994, dhe Johannesburg 2002, kanë qenë momente historike në procesin e reagimit ndaj njëres nga sfidat më të mëdha të njerëzimit: qëndrueshmërisë së ambientit. Situata aktuale gjithashtu ofron dëshmi të mjaftueshme se diversiteti kulturor në botë është në rrezik për shkak të globalizimit, i cili standardizon dhe përjashton. UNESCO thotë: “Një burim i shkëmbimit, inovacionit dhe kreativitetit është i domosdoshëm për njerëzimin ashtu si është biodiversiteti për natyrën” (Deklarata Universale mbi Diversitetin Kulturor e UNESCO-s, artikulli 1).
3. Qeveritë lokale e pranojnë që të drejtat kulturore janë pjesë integruese e të drejtave të njeriut, duke iu referuar Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (1948), Marrëveshjes Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1966) dhe Deklaratës Universale mbi Diversitetin Kulturor të UNESCO-s (2001). Ata e pranojnë që liria kulturore e individëve dhe komuniteteve është kusht esencial për demokraci. Askush nuk mund të thirret në diversitet kulturor që i cenon të drejtat e njeriut të garantuara me ligj ndërkombëtar, e as t'i kufizojë ato.

- 
4. Qeveritë lokale janë agjentë botërorë të rëndësisë primare si mbrojtës dhe promovues të rritjes së të drejtave të njeriut. Ata gjithashtu i përfaqësojnë qytetarët e botës dhe flasin në favor të sistemeve dhe institucioneve demokratike ndërkombëtare. Qeveritë lokale punojnë së bashku në rrjete, duke i shkëmbyer praktikat dhe përvojat dhe duke i koordinuar veprimet e tyre.
  5. Zhvillimi kulturor mbështetet në një nikoqir të agjentëve shoqërorë. Parimi kryesor i qeverisjes së mirë përfshinë transparencë të informatave dhe pjesëmarrje publike në konceptimin e politikave kulturore, në proceset vendimmarrëse dhe vlerësimin e programeve dhe projekteve.
  6. Nevoja e duhur për të krijuar kushte për paqe duhet të shkojë krah për krah me strategjitë zhvillimore kulturore. Lufta, terrorizmi, represioni dhe diskriminimi janë shprehje të jotelorencës që duhet të dënohen dhe të çrrënjosen.
  7. Qytetet dhe hapësirat lokale janë vende të privileguara për shpikje kulturore që janë në evoluim të vazhdueshëm dhe ofrojnë hapësirë për diversitet kreativ, ku puqjet e të gjitha atyre që janë të ndryshme dhe të veçanta (origjinat, vizionet, moshat, gjinitë, grupet etnike dhe klasat shoqërore) janë ato që e bëjnë të mundshëm zhvillimin njerëzor të plotë. Dialogu në mes të identitetit dhe diversitetit, individit dhe grupit, është mjet vital për ta garantuar qytetarinë kulturore planetare por edhe si mbijetesë e diversitetit gjuhësor dhe zhvillimit të kulturave.
  8. Bashkëjetesa në qytete është përgjegjësi e përbashkët e qytetarëve, shoqërisë civile dhe qeverive lokale. Ligjet janë kryesoret, por nuk mund të jenë e vetmja mënyrë e rregullimit të bashkëjetesës në qytete. Siç thotë Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut (artikulli 29): “Çdokush ka detyrime ndaj komunitetit ku zhvillimi i lirë dhe i plotë i personalitetit të tij/saj...është i mundshëm”.
  9. Trashëgimia kulturore e prekshme dhe e paprekshme, dëshmon për kreativitetin e njerëzimit dhe formon themel të fortë në identitetin e njerëzve. Jeta kulturore përmban mirëqenie që e bën të mundur vlerësimin dhe ruajtjen e traditave të të gjithë njerëzve si dhe një rast për të mundësuar krijimin dhe përtëritjen e formave kulturore endogjene (të brendshme). Këto kualitete e parandalojnë imponimin e modeleve kulturore të ngurta.
  10. Afirmimi i kulturave dhe politikat të cilat e përkrahin njohjen dhe zbatueshmërinë e tyre, janë faktor esencial në zhvillimin e qëndrueshëm të qyteteve dhe territoreve dhe të dimensionit njerëzor, ekonomik, politik dhe social të tyre. Natyra qendrore e politikave kulturore publike është kërkesë e shoqërive në botën bashkëkohore. Kualiteti i zhvillimit lokal varet nga gërshetimi i politikave kulturore dhe politikave tjera publike – sociale, ekonomike, arsimore, ambientale dhe të planifikimit urbanistik.



- 
11. Politikat kulturore duhet ta gjejnë bilancin në mes të interesit publik dhe privat, funksioneve publike dhe institucionalizimit të kulturës. Institucionalizimi i tepërt dhe zotërimi i tepërt i tregut si distributor i vetmi i resurseve kulturore ngërthen rreziqe dhe e pengon zhvillimin dinamik të sistemeve kulturore. Iniciativa autonome e qytetarëve, si individë apo si entitete dhe lëvizje sociale, është bazë për liri kulturore.
  12. Vlerësimi i duhur ekonomik i krijimit dhe shpërndarjes së të mirave kulturore – amatore ose profesionale, të zanatit apo industriale, individuale apo kolektive – bëhen, në botën bashkëkohore, faktor vendimtar në emancipim, garanci për diversitet dhe, si rrjedhojë, një përmbushje e të drejtave demokratike të njerëzve për t'i afirmuar identitetet e tyre në marrëdhëniet në mes të kulturave. Të mirat dhe shërbimet kulturore, ashtu si caktohen në Deklaratën Universale të Diversitetit Kulturor të UNESCO-s (artikulli 8), “ si vektorët e identitetit, vlerat dhe kuptimet, nuk duhet të trajtohen vetëm si produkte apo të mira konsumuese”. Duhet të theksohet rëndësia e kulturës si faktor në krijimin e pasurisë dhe zhvillimit ekonomik.
  13. Qasja në universin kulturor dhe simbolik, në të gjitha etapat e jetës, nga fëmijëria në pleqëri, është element themelor në formësimin e ndjeshmërisë, të shprehurit dhe bashkëjetesës, si dhe në ndërtimin e qytetarisë. Identiteti kulturorë i secilit individ është dinamik.
  14. Përvetësimi i informacioneve dhe transformimi i tyre në njohuri nga qytetarët është akt kulturor. Prandaj qasja jodiskriminuese në resurset shprehëse, teknologjike dhe komunikuese, dhe konstituimi i rrjeteve horizontale e forcon dhe ushqen trashëgiminë kolektive të shoqërisë që bazohet në njohuri.
  15. Puna është një nga sferat primare të kreativitetit njerëzor. Dimensionin kulturor i saj duhet të njihet dhe zhvillohet. Organizimi i punës dhe përfshirja e bizneseve në qytet apo territor duhet ta respektojë këtë dimension si një nga elementet themelore në dinjitetin njerëzor dhe zhvillimin e qëndrueshëm.
  16. Hapësirat publike janë të mira kolektive që ju përkasin të gjithë qytetarëve. Asnjë individ apo grupi nuk mund t'i mohohet e drejta për t'i përdorur ato, duke nënkuptuar që ata i respektojnë rregullat e miratuara nga secili qytet.

---

## II. Ndërmarrjet

17. Të vendosen politikat që e mirëmbajnë diversitetin kulturor me qëllim të garantimit të furnizimit të gjerë dhe promovimit të prezencës në media të të gjitha kulturave, në veçanti të kulturave të minoriteteve ose atyre të pambrojtura si dhe përkrahja e bashkë-prodhimeve dhe shkëmbimeve duke iu shmangur kështu pozicioneve hegjemoniste.
18. Të përkrahet dhe promovohet, përmes mjeteve dhe instrumenteve të ndryshme, mirëmbajtja dhe zgjerimi i të mirave dhe shërbimeve kulturore, duke siguruar qasje universale në to, duke rritur kapacitetin e të gjithë qytetarëve, mirëqenien e përfaqësuar nga diversiteti gjuhësor, duke promovuar kualitetin artistik, duke kërkuar forma të reja të së shprehurit dhe eksperimentimi me gjuhë të reja të artit, si dhe riformulimi dhe bashkëveprimi në mes të traditave dhe zbatimi i mekanizmave për menaxhim kulturor të cilët zbulojnë lëvizje të reja kulturore dhe talente të reja artistike dhe i inkurajojnë ato për të arritur plotësinë. Qeveritë lokale e deklarojnë vendosmërinë e tyre për të krijuar dhe rritur audiencat kulturore dhe duke inkurajuar pjesëmarrjen kulturore si element vital të qytetarisë.
19. Të zbatohen instrumentet e duhura për të garantuar pjesëmarrjen demokratike të qytetarëve në formulimin, ushtrimin dhe vlerësimin e politikave publike kulturore.
20. Të garantohen fondet publike për kulturës me mjete dhe instrumente të domosdoshme. Në mes këtyre janë financimi direkt i programeve dhe shërbimeve publike, përkrahja për aktivitetet e ndërmarrjeve private përmes subvencionimeve dhe modeleve të reja si mikro-kreditë, fondet 'venture capital', etj. Gjithashtu, mund të konsiderohet vendosja e sistemeve ligjore për të ofruar lehtësime në tatim për kompanitë që investojnë në kulturë, duke nënkuptuar që këto kompani e respektojnë interesin publik.
21. Të hapen hapësirat për dialog në mes të zgjedhjeve të ndryshme religjioze dhe shpirtërore mes komuniteteve që jetojnë pranë njëri tjetrit në zona lokale dhe në mes të atyre grupeve dhe autoriteteve publike për të siguruar të drejtën e lirisë së fjalës dhe bashkëjetesë harmonike.
22. Të promovohet të shprehurit si dimension bazë i dinjitetit njerëzor dhe përfshirjes sociale pa paragjykimë në gjini, moshë, origjinë etnike, aftësi të kufizuar, varfëri apo çfarëdo lloj diskriminimi, i cili mund ta ndalojë ushtrimin e plotë të lirisë. Beteja kundër përjashtimit është betejë për dinjitetin e të gjithë njerëzve.
23. Të promovohet vazhdimësia dhe zhvillimi i kulturave lokale vendase, të cilat janë bartëse të marrëdhënieve historike dhe bashkëvepruese me territorin.

- 
24. Të garantohet shprehja kulturore dhe pjesëmarrja e njerëzve me kultura nga imigrimi ose me prejardhje nga zonat tjera. Në të njëjtën kohë, qeveritë lokale ndërmarrin veprime për të ofruar mjete që imigrantët të kenë qasje dhe të marrin pjesë në kulturën e komunitetit nikoqir. Ky zotim reciprok është themel për bashkëjetesë dhe procese ndërkulturore, gjë që në fakt, pa këtë emër, ka kontribuar në krijimin e identitetit të secilit qytet.
  25. Të promovohet zbatimi i formave për “vlerësim të ndikimit kulturor” si shqyrtim i detyrueshëm i iniciativave publike apo private që përfshijnë ndryshime të rëndësishme në jetën kulturore të qyteteve.
  26. Të meren në konsiderim parametrat kulturorë në të gjitha planifikimet urbane dhe rajonale, vendosja e ligjeve, rregullave dhe rregulloreve të nevojshme për të siguruar mbrojtjen e trashëgimisë kulturore lokale dhe trashëgiminë e gjeneratave të mëparshme.
  27. Të promovohet ekzistenca e hapësirave publike të qytetit dhe mirëmbajtja e tyre si vende kulturore për bashkëveprim dhe bashkëjetesë. Të nxitet kujdesi për estetikën e hapësirave publike dhe pajisjeve kolektive.
  28. Të zbatohen masat për decentralizimin e politikave dhe resurseve kulturore, duke legjitimuar origjinalitetin kreativ të të ashtuquajturave periferive, duke favorizuar sektorët e brishtë të shoqërisë dhe duke mbrojtur parimin se të gjithë njerëzit kanë të drejtë pa diskriminim në kulturë dhe dituri. Kjo vendosmëri nuk do të thotë anashkalim i përgjegjësive kryesore, e në veçanti, i përgjegjësive për financimin të çfarëdo projekti të decentralizimit.
  29. Të promovohen në veçanti koordinimi në mes të politikave kulturore të qeverive lokale që e ndajnë një territor, duke krijuar dialogu që e çmon identitetin e secilit autoritet, kontributin e tyre ndaj tërësisë dhe efektivitetin e shërbimeve për qytetarët.
  30. Të gjallërohet roli strategjik i industrive kulturore dhe mediave lokale për kontributin e tyre ndaj identitetit lokal, vazhdimësisë kreative dhe krijimit të vendeve të punës.
  31. Të promovohet shoqërizimi dhe qasja në dimensionin digjital të projekteve dhe trashëgimisë kulturore lokale dhe globale. Teknologjitë e informimit dhe komunikimit duhet të përdoren si mjete për t’ua sjellë njohurinë kulturore qytetarëve.
  32. Të zbatohen politika, qëllimi i të cilave është promovimi i qasjes në mediat publike lokale dhe zhvillimi i këtyre mediave në harmoni me interesat e komunitetit, duke i përcjellë parimet e pluralitetit, transparencës dhe përgjegjësive.
  33. Të gjenerohen mekanizmat, instrumentet dhe resurset për garantimin e lirisë së fjalës.
  34. Të respektohen dhe garantohen të drejtat morale të autorëve dhe artistëve si dhe të sigurohet shpërblimi i drejtë për ta.

- 
35. Të ftohen krijuesit dhe artistët që të zotohen për qytetin dhe territorin duke i identifikuar problemet dhe konfliktet e shoqërisë sonë, duke e përmirësuar bashkëjetesën dhe kualitetin e jetës, duke i rritur kapacitetet krijuese të të gjithë qytetarëve, e në veçanti, duke kontribuar në zgjidhjen e sfidave me të cilat ballafaqohen qytetet.
  36. Të vendosen politikat dhe investimet për nxitjen e të lexuarit dhe shpërndarjen e librave, si dhe qasjen e plotë për të gjithë qytetarët në prodhimtarinë letrare globale dhe lokale.
  37. Të ushqehet karakteri publik dhe kolektiv i kulturës, duke promovuar kontaktin e të gjithë sektorëve të qytetit me të gjitha format e të shprehurit që i favorizojnë festimet: interpretimet e gjalla, filmat, festivalet etj.
  38. Të gjenerohet koordinimi në mes të politikave kulturore dhe arsimore, duke nxitur promovimin e kreativitetit dhe ndjeshmërisë dhe marrëdhënieve në mes të shprehjeve kulturore të territorit dhe sistemit arsimor.
  39. Të garantohet që njerëzit me aftësi të kufizuara mund t'i gëzojnë të mirat dhe shërbimet kulturore, duke lehtësuar qasje e tyre në shërbimet dhe aktivitetet kulturore.
  40. Të promovohen marrëdhëniet në mes të pajisjeve kulturore dhe subjekteve tjera që merren me dituri, si universitetet, qendrat hulumtuese dhe kompanitë hulumtuese.
  41. Të promovohen programet që kanë për qëllim popullarizimin e kulturës shkencore dhe teknike në mes të qytetarëve, duke pasur parasysh në veçanti që çështjet etike, sociale, ekonomike dhe politike që ngrihen nga aplikimi i njohurisë së re shkencore, janë të interesit publik.
  42. Të vendosen instrumentet ligjore dhe të zbatohen aksionet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore me anë të inventarizimit, regjistrimit, katalogimit dhe promovimit si dhe të popullarizohet vlerësimi i trashëgimisë përmes aktiviteteve siç janë ekspozitat, muzetë ose itineraret.
  43. Të mbrohet, vlerësohet dhe popullarizohet trashëgimia dokumentare lokale e gjeneruar në sferën lokale/rajonale, me vetiniciativë ose në shoqërim me subjektet publike dhe private, duke ofruar stimulim për krijimin e sistemeve komunale dhe rajonale për atë qëllim.
  44. Të inkurajohet hulumtimi i lirë i trashëgimisë kulturore nga të gjithë qytetarët në të gjitha pjesët e botës. Të promovohet, në bashkëpunim me profesionistët e këtij sektori, format e turizmit që respektojnë kulturat dhe zakonet e lokaliteteve dhe territoreve të vizituara.
  45. Të zhvillohen dhe zbatohen politikat që thellojnë proceset multilaterale të bazuara në principet e reciprocitetit. Bashkëpunimi kulturor ndërkombëtar është mjet i domosdoshëm për themelimin e një komuniteti njerëzor përkrahës, i cili promovon qarkullimin e lirë të operatorëve artistikë dhe kulturorë, në veçanti përmes kufijve veri-jug, si një kontribut thelbësor për të bërë dialog në mes të njerëzve për ta tejkualuar çekuilibrin e sjell nga kolonializmi, dhe për integrim rajonal.

---

## III. Rekomandimet

### PËR QEVERITË LOKALE

46. Të gjitha qeveritë lokale ftohen ta dorëzojnë këtë dokument për miratim te trupat e tyre ligjvënës dhe të ndërmarrin debat të gjerë me shoqërinë lokale.
47. Të sigurohet vendi qendror i kulturës në politikat lokale dhe të promovohet hartimi i Agjendës 21 për kulturë në çdo qytet ose territor, në koordinim të ngushtë me proceset e pjesëmarrjes publike dhe planifikimit strategjik.
48. Të bëhen propozime për të rënë në dakord për mekanizmat e menaxhimit të kulturës me nivelet tjera institucionale, gjithmonë duke respektuar parimin e subvencionimit.
49. Të përmbushet, para vitit 2006, propozimi për sistem të indikatorëve kulturorë që e përkrahin shpërndarjen e kësaj Agjende 21 për kulturë, duke përfshirë këtu metoda për lehtësimin e monitorimit dhe krahasimit.

### PËR QEVERITË SHTETËRORE DHE NACIONALE

50. Të krijohen instrumentet për ndërhyrje publike në fushën e kulturës, duke pasur parasysh rritjen e nevojave kulturore të qytetarëve, mangësitë aktuale të programeve dhe resurseve kulturore dhe rëndësinë e transferimit dhe shpërndarjes buxhetore. Për më shumë, është e domosdoshme të punohet në caktimin e minimumit prej 1% nga buxheti nacional atë të kulturës.
51. Të vendosen mekanizmat për konsultim dhe marrëveshje me qeveritë lokale, drejtpërsëdrejti apo përmes rrjeteve dhe federatave të tyre, për të bërë legjislacion, rregulla dhe sisteme për financime në fushën kulturore.
52. Të shmangen nga marrëveshjet tregtare që kufizojnë zhvillimin e lirë të kulturës dhe shkëmbimin e të mirave dhe shërbimeve kulturore në kushte të barabarta.
53. Të miratohen provizionet ligjore për të shmangur centralizimin e industrive kulturore dhe komunikuese, për ta promovuar bashkëpunimin, në veçanti në fushën e prodhimit, me përfaqësues dhe agjentë lokalë dhe rajonalë.
54. Të garantohen përmendja të adekuate për prejardhjen e të mirave kulturore të ekspozuara në territoret tona dhe miratoni masa për parandalimin e trafikimit ilegal të të mirave që i përkasin trashëgimisë historike të njerëzve tjerë.
55. Të zbatohen, në nivel shtetëror ose nacional, marrëveshjet për diversitetin kulturor, në veçanti Deklaratën Universale për Diversitet Kulturor të UNESCO-s, të miratuar në Konferencën e 31-të të Përgjithshme, në nëntor të vitit 2001, dhe Planin e Aksionit mbi Politika Kulturore për Zhvillim të miratuar në Konferencën Ndërqeveritare në Stokholm (1998).

---

## PËR ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE

### *ORGANIZATAT E QYTETEVE*

56. Për Qytetet dhe Qeveritë Lokale të Bashkuara: miratoni Agjendën 21 për kulturë si dokument referimi për programet e tyre kulturore dhe gjithashtu parashiheni rolin e tyre si koordinatorë të procesit, pas miratimit të saj.
57. Për rrjetet kontinentale të qyteteve dhe qeverive lokale (në veçanti për ato që e promovuan Agjendën 21 si Interlocal, Eurocities, Sigma apo Mercociudades): shqyrtojeni këtë dokument brenda veprimeve të tyre teknike dhe programeve të politikave.

### *PROGRAMET DHE AGJENSITË E KOMBEVE TË BASHKUARA*

59. Për UNESCO-n: ta pranoj Agjendën 21 për Kulturë si dokument referues në punën e saj për përgatitjen e instrumentit ligjor apo Konventës mbi Diversitetin Kulturor të planifikuar për vitin 2005.
59. Për UNESCO-n: t'i pranoj qytetet si territore ku aplikohen parimet e diversitetit kulturor, në veçanti ato aspekte që kanë të bëjnë me bashkëjetesën, demokracinë dhe pjesëmarrjen; dhe t'i vendosni mjetet për qeveritë lokale që ato të marrin pjesë në programet e saj.
60. Për Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP): të thellojë analizën e saj të kulturës dhe zhvillimit dhe të përfshijë indikatorët kulturorë në kalkulimin e indeksit të zhvillimit njerëzor (HDI).
61. Për Departamentin e Çështjeve Ekonomike dhe Sociale – Sektori i Zhvillimit të Qëndrueshëm, i cili është përgjegjës për monitorimin e Agjendës 21: të zhvillojë dimension kulturor të qëndrueshmërisë duke i ndjekur parimet dhe vendimet e Agjendës 21 për Kulturë.
62. Për HABITAT-in e Kombeve të Bashkuara: ta shqyrtojë këtë dokument si bazë për ndërtimin e rëndësisë së dimensionit kulturor në politikat urbane.
63. Për Komitetin e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore: ta përfshijë dimensionin urban në analizat e tij të marrëdhënieve në mes të të drejtave kulturore dhe të drejtave të tjera të njeriut.

### *ORGANIZATAT NDËRQEVERITARE DHE MBI-KOMBËTARE*

64. Për Organizatat Botërore të Tregtisë: t'i përjashtojnë të mirat dhe shërbimet kulturore nga raundet e tyre të negociatave. Baza për shkëmbim e të mirave kulturore duhet të vendoset në një instrument të ri ligjor ndërkombëtar siç është Konventa mbi Diversitetin Kulturor të planifikuar më 2005.

- 
65. Për organizatat kontinentale (Bashkimi Evropian, Mercosur, Bashkimi Afrikan, Asociacioni i Kombeve të Azisë Juglindore): ta përfshijë kulturën si shtyllë të ndërtimit të tyre. Me respektimin e kompetencave dhe subvencionimeve nacionale, paraqitet nevoja për politikë kulturore kontinentale, të bazuar në parimet e legjitimitetit të intervenimit publik në kulturë, diversitet, pjesëmarrje, demokraci dhe rrjetëzim.
66. Për trupat multilaterale të themeluara në parimet e afinitetit kulturor (për shembull, Këshilli i Evropës, Liga e Shteteve Arabe, Organizata e Shteteve Iberoamerikane, Organizata Frankofone Ndërkombëtare, Komonuelthi, Bashkësia e Vendeve të Gjuhës Portugeze, Bashkimi Latin): të promovohet dialogu dhe projektet e përbashkëta, të cilat çojnë drejt mirëkuptimit më të madh mes të civilizimeve dhe gjeneratave të diturisë dhe besimit të përbashkët, bazë kjo për paqe.
67. Për Rrjetin Ndërkombëtar për Politikën Kulturore (shtetet dhe ministrat e kulturës) dhe Rrjetin Ndërkombëtar për Diversitet Kulturor (asociacionet e artistëve): ti konsiderojnë qytetet si territore kryesore të diversitetit kulturor, të vendosin mekanizma për pjesëmarrjen e qeverive lokale në punën e tyre dhe t'i përfshijnë parimet e vendosura të Agjendës 21 në planet e tyre të veprimit.

Barcelonë, 8 maj, 2004

---

Komitetit për kulturë - Qytetet dhe Qeveritë Lokale të Bashkuara

Committee on culture – United Cities and Local Governments – UCLG

Commission de culture – Cités et Gouvernements Locaux Unis – CGLU

Comisión de cultura – Ciudades y Gobiernos Locales Unidos – CGLU

<http://www.agenda21culture.net>

<http://www.cities-localgovernments.org>

[agenda21cultura@bcn.cat](mailto:agenda21cultura@bcn.cat)

[info@cities-localgovernments.org](mailto:info@cities-localgovernments.org)

Agjenda 21 për kulturë është në dispozicion në gjuhën angleze, frënge, spanjolle, shqipe, arabe, katalone, galiciane, gjermane, italiane, japoneze, perse, polake, portugeze, ruse, serbe, suedeze, turke dhe ukrainase. Angazhuar për diversitet kulturor dhe gjuhësor, Komisioni për kulturë e inkurajon përkthimin e Agjendës 21 për kulturë në më shumë gjuhë.

The Agenda 21 for culture is available in English, French, Spanish, Albanian, Arabic, Bulgarian, Catalan, Galician, German, Italian, Japanese, Persian, Polish, Portuguese, Russian, Serbian, Swedish, Turkish and Ukrainian. Committed to cultural and linguistic diversity, the Committee on culture encourages its translation into more languages.

L'Agenda 21 de la culture est disponible en anglais, français, espagnol, albanais, allemand, arabe, bulgare, catalan, galicien, italien, japonais, perse, polonais, portugais, russe, serbe, suédois, turc et ukrainien. Engagé à la diversité culturelle et linguistique, la Commission de culture encourage sa traduction dans d'autres langues.

La Agenda 21 de la cultura está disponible en inglés, francés, español, albanés, alemán, árabe, búlgaro, catalán, gallego, italiano, japonés, persa, polaco, portugués, ruso, serbio, sueco, turco y ucraniano. Comprometido con la diversidad cultural y lingüística, la Comisión de cultura anima a su traducción a otras lenguas.



**United Cities and Local Governments  
Cités et Gouvernements Locaux Unis  
Ciudades y Gobiernos Locales Unidos**

carrer Avinyó, 15  
E-08002 Barcelona  
Espanya

Tel: +34 93 342 87 50  
Fax: +34 93 342 87 60  
info@cities-localgovernments.org  
www.cities-localgovernments.org

**Ajuntament de Barcelona -  
Institut de Cultura**

Palau de la Virreina - la Rambla 99  
E-08002 Barcelona  
Espanya

Tel: +34 933 161 000  
Fax: +34 933 161 020  
agenda21cultura@bcn.cat  
www.bcn.cat/cultura

**[www.agenda21culture.net](http://www.agenda21culture.net)**



**United Cities and Local Governments  
Cités et Gouvernements Locaux Unis  
Ciudades y Gobiernos Locales Unidos**



**Ajuntament de Barcelona  
Institut de Cultura**